

**Emertimi dhe Forma ligjore:**

**“Isobar Construction” sh.p.k**

**NIPT –i:**

**L12210036D**

**Adresa e Selise:**

**Tirane**

**Data e krijimit:**

**10.10.2011**

**Veprimtaria Kryesore:**

**Ndertim – Projektim, Rikonstruksione**

## **PASQYRAT FINANCIARE**

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2  
dhe Ligjit Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

### **VITI 2020**

Pasqyrat Financiare jane individuale

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek

Pasqyrat Financiare nuk jane te rumbullakosura

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2020-31.12.2020

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 04.02.2021

AKTIVET	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
<b>Aktive afatshkurtra</b>		
<b>Mjete monetare</b>	4,523,955	1,113,037
<b>Investime</b>		
<i>Te tjera financiare</i>	0	0
<b>Te drejta te arketueshme</b>		
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	53,950,336	21,428,200
<i>Te tjera</i>	14,711,226	21,458,579
<i>Kapital i nenshkruar i papaguar</i>	0	0
<b>Inventaret</b>		
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	9,742,631	589,270
<i>Mallra</i>	0	0
<i>Parapagime per inventar</i>	0	0
<b>Shpenzime te shtyra</b>	124,078	73,392
<b>Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara</b>	0	0
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>	83,052,226	44,662,478
<b>Aktive afatgjate</b>		
<b>Aktive financiare</b>		
<b>Aktive materiale</b>		
<i>Toka dhe ndertesa</i>	0	0
<i>Mjete transporti</i>	9,846,559	12,679,184
<i>Impiante dhe makineri</i>	1,467,390	1,781,675
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>	2,571,540	2,672,697
<i>Parapagime per aktive materiale dhe ne proces</i>	0	0
<b>Aktivet biologjike</b>	0	0
<b>Aktive jo materiale</b>		
<b>Aktivet tatimore te shtyra</b>	0	0
<b>Totali i aktiveve afatgjate</b>	13,885,489	17,133,556
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	96,937,715	61,796,034

Administratori



TARELLI  
Alban Tarelli

	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
<i>Titujt e huamarrjes</i>	0	0
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>	4,601,405	0
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	16,308,341	19,036,112
<i>Parapagime</i>	1,549,145	0
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	10,753,726	6,276,125
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	1,139,579	19,712
<i>Te tjera te pagueshme</i>	18,638,835	15,519,000
<b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>	0	0
<b>Te ardhura te shtyra</b>	0	0
<b>Provizione</b>	0	0
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>52,991,031</b>	<b>40,850,949</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>		
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>	19,287,786	0
<b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>	0	0
<b>Te ardhura te shtyra</b>	0	0
<b>Provizione</b>		
<b>Detyrime tatimore te shtyra</b>	0	0
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>	<b>19,287,786</b>	<b>0</b>
<b>Detyrime totale</b>	<b>72,278,817</b>	<b>40,850,949</b>
<b>Kapitali dhe Rezervat</b>		
<b>Kapitali i nenshkruar</b>	1,863,000	1,863,000
<b>Primi i lidhur me kapitalin</b>	0	0
<b>Rezerva rivleresimi</b>	0	0
<b>Rezerva te tjera</b>		
<i>Rezerva ligjore</i>	0	0
<i>Rezerva te tjera</i>	7,124,992	7,124,992
<b>Fitimi/(humbja) e pashperndare</b>	0	0
<b>Fitimi/(humbja) e periudhes</b>	15,670,906	11,957,093
<b>Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike</b>	<b>24,658,898</b>	<b>20,945,085</b>
<b>Interesa jo-kontrollues</b>		
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>24,658,898</b>	<b>20,945,085</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>	<b>96,937,715</b>	<b>61,796,034</b>



Administratori

Alban Tarelli

	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhese
<b>Pasqyra e Performances (sipas natyres)</b>		
<b>Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit</b>		
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	97,550,423	77,489,187
<b>Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces</b>	0	0
<b>Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar</b>	0	0
<b>Te ardhura te tjera te shfrytezimit</b>	0	4,960,000
<b>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</b>		
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	-29,472,929	-31,246,727
<i>Te tjera shpenzime</i>	-14,748,478	-7,365,082
<b>Shpenzime te personelit</b>		
<i>Paga dhe shperblime</i>	-6,116,814	-6,779,139
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	-1,021,507	-1,132,111
<i>Shpenzimet per pensionet</i>	0	0
<b>Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale</b>	0	-4,442,199
<b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	-4,998,879	-3,628,202
<b>Shpenzime te tjera shfrytezimi</b>	-20,216,992	-13,599,747
<b>Te ardhura te tjera</b>		
<b>Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra</b>	0	0
<b>Shpenzime financiare</b>		
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme</i>	-2,201,353	-91,198
<i>Shpenzime te tjera financiare</i>	-8,170	0
<b>Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet</b>	0	0
<b>Te tjera (pershkruaj)</b>	0	0
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>	<b>18,765,301</b>	<b>14,164,782</b>
<b>Tatimi mbi fitimin</b>		
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i>	-3,094,395	-2,207,689
<b>Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)</b>	<b>15,670,906</b>	<b>11,957,093</b>
<b>Te ardhura te tjera gjithepershiresë per periudhen/vitin:</b>		
<b>Totali i te ardhurave te tjera gjithepershiresë per periudhen/vitin (B)</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Totali i te ardhurave gjithepershiresë per periudhen/vitin (A+B)</b>	<b>15,670,906</b>	<b>11,957,093</b>



Administratori

Alban Tarelli



	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhese
<b>Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (metoda indirekte)</b>		
<b>Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:</b>		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	18,765,301	14,164,782
Rregullime per te ardhura dhe shpenzime jo-monetare:		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	4,998,879	3,628,202
<i>Shpenzime te shtyra</i>	(50,686)	83,099
<i>Zbritet fitimi nga aktivitet investuese</i>		-517,801
<i>Vlera kontabel e aktivitet te shitur</i>		4,442,199
Fluksi i mjeteve monetare i perfshire ne aktivite investuese		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	0	517,801
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	-25,774,783	1,459,188
Rënie/(rritje) në inventarë	-9,153,361	-54,112
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	11,025,415	14,107,106
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	0	0
<b>Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit</b>	<b>-189,235</b>	<b>37,830,464</b>
<b>Tatim fitimi i paguar gjate periudhes</b>	<b>-1,979,728</b>	<b>-500,000</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit</b>		
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	-1,750,812	-3,834,762
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	0	0
<i>Dividentë të arkëtuar</i>	0	0
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit</b>	<b>-1,750,812</b>	<b>-3,834,762</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit</b>		
<i>Dividendë të paguar</i>	-11,957,093	-39,000,000
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme financiare</i>	19,287,786	0
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit</b>	<b>7,330,693</b>	<b>-39,000,000</b>
<b>Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to</b>	<b>3,410,918</b>	<b>-5,504,298</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	1,113,037	6,617,335
Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare	0	0
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund</b>	<b>4,523,955</b>	<b>1,113,037</b>

Administratori  
**ALBAN TARELLI**  
Alban Tarelli



Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto	Kapitali i nenshkuar	Rezerva te tjera	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali
<b>Pozicioni financiar ne fillim</b>	<b>40,863,000</b>	<b>806</b>	<b>7,124,186</b>	<b>47,987,992</b>
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile				0
<b>Pozicioni financiar i ridekluarar ne fillim</b>	<b>40,863,000</b>	<b>806</b>	<b>7,124,186</b>	<b>47,987,992</b>
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:</b>				0
Fitim/(humbja) e periudhes			11,957,093	11,957,093
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse				0
<b>Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>11,957,093</b>	<b>11,957,093</b>
<b>Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:</b>				0
Emetim i kapitalit të nënshkuar				0
Dividende te shperndare	-39,000,000			-39,000,000
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)		7,124,186	-7,124,186	0
<b>Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike</b>	<b>-39,000,000</b>	<b>7,124,186</b>	<b>-7,124,186</b>	<b>-39,000,000</b>
<b>Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes)</b>	<b>1,863,000</b>	<b>7,124,992</b>	<b>11,957,093</b>	<b>20,945,085</b>
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:</b>				0
Fitim/(humbja) e periudhes			15,670,906	15,670,906
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse				0
<b>Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>15,670,906</b>	<b>15,670,906</b>
<b>Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:</b>				0
Emetim i kapitalit të nënshkuar				0
Dividende te shperndare			-11,957,093	-11,957,093
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)				0
<b>Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>-11,957,093</b>	<b>-11,957,093</b>
<b>Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)</b>	<b>1,863,000</b>	<b>7,124,992</b>	<b>15,670,906</b>	<b>24,658,898</b>

Administratori



Alban Tarelli



**SHENIMET SHPJEGUESE****1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria « **Isobar Construction** » shpk është regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar me datë 10.10.2011, me ortak të vetëm dhe administrator Z. Alban Tarelli. Kapitali i shoqërisë është 1,863,000 leke dhe kuota e tij zotërohet 100% nga ortakët I vetëm.

Shoqëria ushtron aktivitetet në fushën e ndërtimit, rikonstrukcione dhe gjatë vitit 2020 ka patur mesatarisht 14 të punësuar (viti 2019 mesatarisht 18 të punësuar).

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008 "*Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" statutit të saj dhe legjislativës shqiptare në fuqi.

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare****2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*". Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "*Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre*", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

**2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

**2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

**2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

**2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të

arkëtueshme.

### 2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

## 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Euro/LEK	123.70	121.77
USD/ LEK	100.84	108.64

### 3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç



përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

### 3.4 Aktive afatgjata materiale

#### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktiviteti afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:



Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të Tjera	Vlera e mbetur	20%

#### iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### 3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

#### 3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### 3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### 3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### 3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.



Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritët të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

### 3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

### 3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### 3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### 3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

**Bilanci Kontabel, aktivet****4. Aktivet monetare**

Aktivitet monetare me 31.12.2020 jane ne shumen 4,523,955 leke, te pasqyruara me te detajuara ne tabelen e meposhtme:

Nr	Likujditete	Viti 2020	Viti 2019
1	Depozita ne banke	4,467,919	1,107,360
2	Para ne arke	56,036	5,678
	<b>Totali</b>	<b><u>4,523,955</u></b>	<b><u>1,113,037</u></b>

Depozitat ne banke ne monedhe te huaj jane te konvertura me kursin e dates 31.12.2020, diferencat nga kursi i kembimit jane te pasqyrura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

**5. Te drejta te arketueshme**

Paraqitet shuma e kerkesave te arketueshme prej 68,661,562 leke deri me 31.12.2020, te cilat te detajuara paraqiten si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Klient per shitje e sherbime	53,950,336	21,428,200
2	Tvsh	14,701,576	21,458,579
3	Mbipagese ne dogane	9,650	-
	<b>Totali</b>	<b><u>68,661,562</u></b>	<b><u>42,886,779</u></b>

**5.1 Klient per shitje e sherbime**

Paraqiten kerkesa ndaj klienteve me 31.12.2020 ne shumen 53,950,336 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2020 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

**5.2 TVSH**

Paraqitet gjendja e tvsh-se kreditore deri me 31.12.2020 ne shumen 14,701,576 leke.

**5.3 Të kerkueshme te tjera**

Paraqitet gjendja e mbipageses ne dogane me 31.12.2020 ne shumen 9,650 leke.

**6. Inventarët**

Ne kete post paraqitet inventari i materialeve te ndertimit gjendje me 31.12.2020 ne shumen 9,742,631 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Materiale ndertimi	9,742,631	589,270
	<b>Totali</b>	<b><u>9,742,631</u></b>	<b><u>589,270</u></b>

Gjendja e materialeve eshte vleresuar me kosto mesatare. Gjate vitit 2020 nuk eshte ndryshuar menyra e mbajtjes se inventarit e cila vazhdon te jete me kosto mesatare.

**7. Shpenzime të shtyra**

Ne kete post paraqitet me 31.12.2020 shpenzime te cilat i perkasin periudhave te ardhshme ne shumen 124,078 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Shpenzime te shtyra	124,078	73,392
	<b>Totali</b>	<b><u>124,078</u></b>	<b><u>73,392</u></b>



**8. Aktive materiale**

Aktivitet afat gjata materiale jane te paraqitura me koston e blerjes minus amortizimin e vitit. Vlera kontabel e tyre eshte 13,885,489 leke, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Emertimi	Mjete transporti	Makineri e pajisje	Te tjera ne shfrytezim	Totali
<b>I</b>	<b>Aktive afat gjata materiale</b>				
1	Gjendja me 31.12.2019	23,943,912	4,384,977	5,020,779	33,349,668
2	Shtesat per 2020	1,203,212	43,500	504,099	1,750,811
3	Paksimet per 2020		-	-	-
4	Gjendja me 31.12.2020	<u>25,147,124</u>	<u>4,428,477</u>	<u>5,524,877</u>	<u>35,100,480</u>
<b>II</b>	<b>Amortizimi I AQT-ve</b>				
1	Gjendja me 31.12.2019	11,264,728	2,603,301	2,348,085	16,216,113
2	Shtesat per 2020	4,035,837	357,785	605,257	4,998,879
3	Paksimet per 2020		-	-	-
4	Gjendja me 31.12.2020	<u>15,300,565</u>	<u>2,961,086</u>	<u>2,953,341</u>	<u>21,214,992</u>
<b>III</b>	<b>Vlera neto 31.12.2020</b>	<u>9,846,559</u>	<u>1,467,390</u>	<u>2,571,540</u>	<u>13,885,489</u>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019.

**Bilanci kontabel, pasivet**

**9. Detyrime afatshkurtra**

Paraqiten detyrimet afatshkurtra te shoqerise me 31.12.2020 ne shumen 52,991,031 leke, te detajuara si me poshte :

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2020	Viti 2019
1	Detyrimi afatshkurter Kredi OTP Bank	4,595,242	-
2	Interes i maturuar, i papaguar	6,163	-
3	Detyrime per furnitore	16,308,341	19,036,112
4	Parapagime te marra	1,549,145	-
5	Detyrime per paga/sigurime/dieta	10,753,726	6,276,125
6	Detyrime tatimore	1,139,579	19,712
7	Te tjera te pagueshme	18,638,835	15,519,000
	<b>Shuma</b>	<u>52,991,031</u>	<u>40,850,949</u>

**9.1 Detyrime ndaj institucioneve te kredise**

Paraqitet gjendja e detyrimit afatshkurter per kredine qe ka marre shoqeria prane OTP Bank ne shumen 4,595,242 leke.

**9.2 Detyrim per interes kredie te maturuar**

Paraqitet gjendja e detyrimit te interesit te maturuar te kresise, po te papaguar derime 31.12.2020 ne shumen 6,163 leke.



9.3 Detyrime per Furnitore

Paraqitet gjendja e palikujduar e furnitoreve me 31.12.2020 ne shumen 16,308,341 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2020 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

9.4 Parapagime

Paraqitet vlera e parapagimeve te marra nga shoqeria per shitje e sherbime deri me 31.12.2020 ne shumen 1,549,145 leke.

9.5 Te pagueshme ndaj punonjesve

Paraqitet detyrimi ndaj punonjesve per paga, dieta e sigurime shoqerore te palikujduar deri me 31.12.2020 ne shumen 10,753,726 leke.

9.6 Te pagueshme per detyrime tatimore

Jane pasqyruar detyrimet e shoqerise ndaj tatimeve jane ne shumen 1,139,579 leke si me poshte:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2020	Viti 2019
1	Tatimi mbi te ardhurat personale	17,550	12,350
2	Tatim ne burim	7,245	7,245
3	Tatim fitimi sipas bilancit	1,114,784	117
	<b>Shuma</b>	<b><u>1,139,579</u></b>	<b><u>19,712</u></b>

9.6 Te tjera te pagueshme

Paraqitet shuma e detyrimit per dividend te shperndare nga shoqeria po te palikujduar deri me 31.12.2020 ne vleren 18,638,835 leke. **Theksojme se shoqeria e ka paguar detyrimin per tatimin mbi dividendin sipas afateve ligjore.**

10. Detyrime afatgjata

Detyrimet afatgjata te shoqerise me 31.12.2020 paraqiten ne shumen 19,287,786 leke, dhe perfaqesojne detyrimin per kredine qe ka marre shoqeria prane OTP Bank, si me poshte :

Nr	Detyrimet afatgjata	Viti 2020	Viti 2019
1	Detyrimi afatgjate Kredi	19,287,786	-
	<b>Shuma</b>	<b><u>19,287,786</u></b>	<b><u>-</u></b>

11. Kapitali

Gjate vitit 2020 jane shtuar kapitalet e veta me fitimin e vitit ne shumen 15,670,906 leke. Shoqeria ka shperndare dividend ne shumen 11,957,093 leke. Totali i kapitaleve te veta te shoqerise me 31.12.2020 eshte 24,658,898 leke.

Nr	Emertimi	Kapitali i nenshkruar	Rezerva te tjera	Shperndarje dividenti	Fitimi i vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2019	1,863,000	7,124,992	-	11,957,093	20,945,085
2	Shtesat per 2020	-	-	11,957,093	15,670,906	27,627,999
3	Pakesimet per 2020	-	-	(11,957,093)	(11,957,093)	(23,914,186)
	<b>Gjendja me 31.12.2020</b>	<b><u>1,863,000</u></b>	<b><u>7,124,992</u></b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>15,670,906</u></b>	<b><u>24,658,898</u></b>

Pasqyra e performances

12. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Paraqiten te ardhurat e realizuara nga aktiviteti per vitin ushtrimor 2020 ne shumen 97,550,423 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Te ardhura nga aktiviteti	97,550,423	77,489,187
	<b>Shuma</b>	<b><u>97,550,423</u></b>	<b><u>77,489,187</u></b>

**Sqarim per moskuadrimin e te ardhurave te paraqitura ne FDP me te ardhurat e paraqitura ne Pasqyrat Financiare**

Nr	Deklaruar ne FDP	Shuma ne leke
1	Furnizime me shkalle 0%	7,315,431
2	Shitje te tatueshme	91,784,137
	<b>Totali I deklarimeve ne FDP (Shuma I)</b>	<b><u>99,099,568</u></b>
Nr	<b>Deklarimet ne Pasqyrat Financiare</b>	
1	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	97,550,423
2	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	-
	<b>Të ardhura totale ne pasqyrat financiare (Shuma II)</b>	<b><u>97,550,423</u></b>
	<b>Shuma I-II</b>	<b><u>1,549,145</u></b>
	<b>Paradhenie klienti per furnizim , paraqitur ne Pasiv</b>	
1	<b>te Pasqyrave Financiare, te Ardhura te Shtyra</b>	1,549,145
	<b>Diference FDP- Pasqyra Financiare</b>	<b><u>-</u></b>

**Sqarim per raportimin e shitjeve ne rubriken “Furnizime me shkalle 0%”:**

Ju sqarojme se shuma e te ardhurave prej 7,315,431 leke, e raportuar ne rubriken “Furnizime me shkalle 0%” perfaqeson vleren e sherbimeve qe shoqeria ka kryer per punimet ne Hidrocentralin e Banjes, per shoqerine “Limak” shoqeri nenkontraktore e “Devoll Hydropower”, e cila ka te drejte te emeroje nenkontraktore te nivelit te 2-te (Isobar Construction), nga ku lind e drejta per te pergatitur fatura te cilat do te jene me TVSH 0% dhe do te pasqyrohen ne rubriken “Furnizime me shkalle 0%” me shenimin perkates “Sipas regjimit specifik të TVSH-së sipas ligjit Nr. 105/2013 date 28.03.2013”.

**13. Te ardhura te tjera te shfrytezimit**

Paraqiten te ardhurat e realizuara te tjera te shfrytezimit per vitin ushtrimor 2020 ne shumen 0 leke, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Te ardhura nga shitja e aktiveve	-	4,960,000
	<b>Shuma</b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>4,960,000</u></b>

**14. Lenda e pare dhe Materiale te konsumueshme**

Shuma e materialeve te konsumuara per vitin 2020 eshte 44,221,407 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Materiale te konsumuara	29,472,929	31,246,727
	<b>Shuma</b>	<b><u>29,472,929</u></b>	<b><u>31,246,727</u></b>
	<b>Te tjera shpenzime</b>		
1	Karburant	14,748,478	7,340,279
2	Shpenzime te tjera	-	24,803
	<b>Shuma e shpenzimeve te tjera</b>	<b><u>14,748,478</u></b>	<b><u>7,365,082</u></b>
	<b>Totali</b>	<b><u>44,221,407</u></b>	<b><u>38,611,809</u></b>



**15. Shpenzime te personelit**

Shpenzimet per personelin paraqiten ne shumen 7,138,321 leke si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2020	Viti 2019
1	Shpenzime per paga	6,116,814	6,779,139
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,021,507	1,132,111
	<b>Shuma</b>	<b><u>7,138,321</u></b>	<b><u>7,911,250</u></b>

**Permbledhesja e pagave per vitin 2020, paraqitet si me poshte:**

Nr	Muaji	Nr punonj	Paga Totale Bruto	Paga mbi te cilen llog. kontributet	Kontribut per sig. shoq. + shend. Punedhenesi	Kontribut per sig. shoq. + shend. Punemarresi	Tatimi ne leke	Paga neto
1	Janar	11	424,773	424,773	70,937	47,574	15,600	361,599
2	Shkurt	11	400,227	400,227	66,838	44,826	14,655	340,746
3	Mars	10	428,636	428,636	71,582	48,007	16,723	363,906
4	Prill	9	405,000	405,000	67,635	45,360	17,550	342,090
5	Maj	9	389,091	389,091	64,979	43,579	16,900	328,613
6	Qershor	9	400,000	400,000	66,800	44,800	16,900	338,300
7	Korrik	10	412,727	412,727	68,925	46,226	16,900	349,601
8	Gusht	15	518,636	518,636	86,611	58,086	18,200	442,350
9	Shtator	15	591,364	591,364	98,758	66,233	21,450	503,681
10	Tetor	13	492,273	492,273	82,210	55,136	17,550	419,588
11	Nentor	27	709,087	709,087	118,418	79,419	17,550	612,118
12	Dhjetor	27	945,000	945,000	157,815	105,841	17,550	821,610
	<b>Shuma</b>		<b><u>6,116,814</u></b>	<b><u>6,116,814</u></b>	<b><u>1,021,507</u></b>	<b><u>685,086</u></b>	<b><u>207,528</u></b>	<b><u>5,224,201</u></b>

**16. Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale**

Jane llogaritur shpenzimet per vleren aktiveve te shitura ne shumen 0 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Zhvleresimi I aktiveve	-	4,442,199
	<b>Shuma</b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>4,442,199</u></b>

**17. Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi**

Jane llogaritur shpenzimet per amortizimin e asetev sipas normave ligjore ne shumen 4,998,879 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Amortizimi I aktiveve	4,998,879	3,628,202
	<b>Shuma</b>	<b><u>4,998,879</u></b>	<b><u>3,628,202</u></b>

**18. Shpenzime te tjera shfrytezimi**

Ne kete ze jane ne shumen 20,216,992 leke, te perfshira si ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Sherbim kontabel e auditimi, ligjor	226,298	585,000
2	Sigurime mjetes	148,411	198,109
3	Materiale ndihmese, veshje pune	7,506,126	4,040,501
4	Kancelari	49,762	84,909
5	Qera	579,600	579,600
6	Shpenzime telefonike	158,970	194,633



7	Sherbime bankare	308,322	27,639
8	Taksa vendore	74,500	67,000
9	Shpenzime dieta per personelin	4,826,000	3,864,000
10	Riparime mjetesh	1,871,176	1,095,756
11	Sherbim parkimi	10,040	10,080
12	Shpenzime hoteli/bileta	-	92,625
13	Te tjera shpenzime personale	88,234	-
14	Te tjera	388,000	78,712
15	Sherbime nga nenkontraktore	3,981,553	2,659,934
16	Kolaudim tahografi	-	21,249
	<b>Shuma</b>	<b><u>20,216,992</u></b>	<b><u>13,599,747</u></b>

**Kuadrimi i blerjeve me shpenzimet e paraqitura ne pasqyrat financiare**

Ne tabelen e meposhtme paraqitet kuadrimi i blerjeve te pasqyruara ne FDP mujore me shpenzimet e perfshira ne pasqyrat financiare per vitin 2020.

Nr	Sipas FDP	Shuma ne leke
1	Blerje te perjashtuara	10,938,494
2	Blerje investimi pa tvsh	31,900
3	Blerje nga furnitore vendas	47,414,819
4	Blerje te investimit brenda vendit me tvsh 20 %	515,700
5	Importe investimi I perjashtuar	1,639,103
6	Import mallra me Tvsh 20%	10,068,610
7	korigjohet me referencen e doganes	(424,189)
	<b>Totali I blerjeve</b>	<b><u>70,184,437</u></b>
<b>Nr</b>	<b>Sipas bilancit</b>	
1	Blerje materialesh	38,626,290
2	<i>korigjohet me Ndryshimin e gjendjes</i>	<i>(9,153,361)</i>
3	Te tjera Shpenzime	14,748,478
3	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	20,216,992
4	Blerje AQT	1,750,812
	<b>Shuma</b>	<b><u>66,189,211</u></b>
	Diferenca	(3,995,226)
	Korigjohet me shpenzimet pa fature	
1	Taksa lokale	(74,500)
2	Sherbime bankare	(308,322)
3	Rimarrje shpenzime te shtyra 2019	124,078
4	Kalim shpenzime te shtyra 2020	(73,392)
5	Dieta personeli	(4,826,000)
	<b>Diference FDP-Bilanc</b>	<b><u>(0)</u></b>

**19. Shpenzime Financiare**

Paraqiten shpenzime ne shumen 2,209,522 leke per vitin 2020, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Gjoha e penalitete	777	-
2	Shpenzime pa fatura te rregullta	7,393	-
3	Humbje nga kursi I kembimit	1,913,146	91,198
4	Interesa kredia OTP Bank	288,206	-
	<b>Totali</b>	<b><u>2,209,522</u></b>	<b><u>91,198</u></b>

**20. Llogaritja e rezultatit tatimor**

Ne tabelen me poshte paraqitet llogaritja e rezultatit tatimor per vitin 2020. Shoqeria per vitin ushtrimor 2020 paraqitet me nje fitim neto prej 15,670,906 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Te ardhura nga aktiviteti	97,550,423	77,489,187
2	Te ardhura te tjera te shfrytezimit	-	4,960,000
	<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>97,550,423</b>	<b>82,449,187</b>
3	Shpenzime	(78,785,122)	(68,284,405)
4	Rezultati i ushtrimit	<b>18,765,301</b>	<b>14,164,782</b>
5	Shpenzime te pazbritshme	<b>1,863,997</b>	<b>553,143</b>
6	Rezultati tatimor	<b>20,629,298</b>	<b>14,717,924</b>
7	Tatim fitimi	(3,094,395)	(2,207,689)
	<b>Fitimi neto</b>	<b>15,670,906</b>	<b>11,957,093</b>

Shpenzimet e pazbritshme ne shumen 1,863,997 leke jane shpenzime te detajuara si me poshte :

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Gjoba e penalitete	777	-
2	Shpenzime pa fatura te rregullta	7,393	-
3	Te tjera shpenzime personale	88,234	78,712
4	Dieta qe tejkalojne 50% e fondit te pagave	1,767,593	474,431
	<b>Totali</b>	<b>1,863,997</b>	<b>553,143</b>

**21. Angazhime dhe pasiguri**

**Çeshtje gjyqesore**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

**22. Ngjarje pas datës së Bilancit**

Situata e krijuar gjate periudhes se fatkeqesise natyrore, te shpallur si pasoje e COVID-19, nuk ndikon ne biznesin tone dhe si pasoje nuk prek parimin e vijimesise, i cili merr parasysh se Shoqëria do te vazhdoje ekzistencen e aktivitetit te saj per nje te ardhme te parashikuar.



Administratori  
**Alban Tarelli**